



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

**MASTER THESIS**

**“Implementation and alalysis of SharePoint system in a public instituion”**

**Supervisor:**

Assoc. Prof.Dr Florije Ismaili

**Candidate:**

Taulant Kurtishi  
ID:123510

## Përmbajtja:

Hyrje.....	3
Rëndësia e studimit.....	4
Hipotezat:.....	5
Metodologjia kërkimore: .....	6
Teknologjitë e shfrytëzuara: .....	7
Hulumtimet e deri më tanishme.....	12
Qeverisja dixhitale dhe strategjia e implementimit të SharePoint portalit.....	37
Vizioni.....	38
Modeli propozuar i qeverisjes dixhitale përmbrnda institucionit .....	40
Arkitektura e intranetit dhe Hub faqet .....	43
Faqet e ekipeve ( Team Sites ) .....	47
Faqet e komunikimit (Communication sites).....	48
Planifikimi i strategjisë së sigurisë ( Plan secure file collaboration ) .....	50
Integrimi i SharePoint në Azure AD B2B .....	51
Operacionet Krijo, Lexo, Përditso, Fshi (CRUD) të integruara në SharePoint.....	52
Krijo (Create):.....	53
Lexo (Read): .....	54
Përditso (Update):.....	56
Fshi ( Delete): .....	57
Branding ( Imazhi ) .....	59
Integrimi i Power BI në SharePoint .....	61
Integrimi i Google Analytics në SharePoint .....	62
Integrimi i Yammer si mjet komunikimi në SharePoint .....	63
Pyetësor për përdorueshmërinë dhe efikasitetin e SharePointit përmbrnda institucionit.....	64
Kërkime të mëtutjeshme dhe përmirësime.....	74
Migrimi në SharePoint Server .....	74
Bibliografia: .....	76
Tabela e figurave.....	79

## Hyrje

Duke marrë parasysh sasinë e dokumenteve, kërkesave, dhe të gjithë dokumenteve transaksionale që gjithnjë është në rritje në institucionet publike, është e rëndësishë primare që institucionet publike të kenë një qasje të sistematizuar në formë sa më produktive në to. Me mbështetjen e një sistemi për menaxhim të dokumentave, institucionet përpiqen që t'i arrijnë objektivat e tyre, në mënyrë që procesi punës të jetë sa më efikas dhe efektiv duke kursyer në kohë dhe shpenzime materiale, gjithnjë duke pasur qasjen, dhe komunikimin në kohën e duhur në dokumentet e nevojshme.

Qëllimi i këtij studimi është të vlersojë se si SharePointi mundëson bashkpunimin, ndarjen e dijes, dhe menaxhimin e kontetit, si dhe të investigojë vlerën që sjell SharePointi në institucione publike. SharePointi si kornizë pune e kompanive që menaxhon me kontentin, procesin e punës, dhe ndarjen e informatave, ka një potencial të pa-prekur sa i përket aplikimit në institucione publike në vendin tonë, andaj implementimi i tij është indikator se institucioni njeh dhe vleron rolin e platformave web si pjesë të rëndësishme në përmirësimin e procesit të punës përbrenda tij.

SharePointi monitoron aftësinë e institucionit në mbarëvajtjen e projekteve, në aspektin kohorë dhe menaxherial, si dhe inkurajon bashkpunim efikas në mes punonjësish duku ju mundësuar atyre ndarje të informacionit, gjurmim dhe menaxhim, si dhe përditsim në detyrat e përditshme. SharePointi si platformë në të shumtën e rasteve gjen përdorim në sektorin privat, përdorimi i tij në sektorin publik dhe zhvillimin i një strukture koherente teknologjike ka ngecje. Meqë lidhshmëria në mes dy sektoreve atij publik dhe privat është e pashmangshme, institucionet publike duhet që të jenë në të njejtën linjë të zhvillimit teknologjik, dhe praktikrat e punës të udhëhiqen nga ndarja dhe menaxhimi i informacionit.

Në rastin e studimit tentohet të përcakohet se sa efektiv është SharePointi përbrenda institucionit dhe çfarë mendimi kanë përdoruesit e tij, gjithashtu të hidhet dritë edhe në ngecjet, dhe nevojat a pa plotësuar të SharePointit. Rëndësi të veçant do të ketë mënyra se si përdoruesi

bashkëvepron me sistemin e menaxhimit të dokumentave në baza ditore, dhe sa plotësohen nevojat e institucionit.

Aspekti teknik i implementit do të jetë i rëndësishëm primare, gjithashtu hulumti përmban edhe një pyetësorë i cili vlerëson eksperiencën e përdoruesve dhe hedh dritë mbi atë se cilat janë pritshmëritë e tyre mbi SharePointin dhe implementimin e tij.

## Rëndësia e studimit

Implementimi i një sistemi të menaxhimit të dokumenteve modern në faza është frytdhënës për përdoruesin dhe institucionin në të cilin implementohet, duke hartuar një strategji të qartë të qeverisjes dixhitale në SharePoint institucioni zgjidh problemin e menaxhimit dhe qartëzon procesin e punës. Meqë strategjia e qeverisjes dixhitale do të jetë lokomotiva e procesit të implementimit, aspekti teknik duhet ta ndjekë nga pas, pasi nevojat dhe sfidat përbrenda institucionit evoluojnë vazhdimisht.

Strategjia e implementimit të SharePointit duhet të ketë vision, qëllime, dhe synim të qartë. Një bashkëveprim i këtyre do sjellë një zgjidhje efektive që përkon me nevojat e institucionit. Studimi do të mbulojë aspektet teknike të implementimit, zhvillimit, dhe dizajnit, por gjithashtu do përgjigjet edhe në pyetjen se “Pse është implementuar dhe çfarë funksioni ka”

Gjatë implementimit të SharePointit, një numër i vogël i punonjësve do mund ta ndjekin dhe testojnë, por implementimi i tij parashihet të jetë për gjithë stafin, dhe institucionin. Testimi do bëhet nga ana e stafit administrativ, stafit akademik dhe studentëve, gjithashtu studimi do kontrollohet nga ana e mentorit, dhe komisionit përkatës.

Implementimi i Intranetit do të bazohet në implementime të mëhershme në institucione publike, dhe procesi i adoptimit do të përshkruhet qartësisht në faza.

## Open Issues (Çështjet e hapuara):

Implementimi i një sistemi të ri është sfidë dhe imponon ndryshim përbrenda institucionit, andaj përveç mënyrës së implementimit, dhe qeverisjes dixhitale nëpërmjet SharePointit e cila trajtohet gjërësisht, nën thjerrzën e observimit do të kërkohet përgjigje edhe për pytyet e më poshtme të cilave do ju jepet përgjigje në kapitullin e fundit të punimit

1: A do të ketë efekt pozitiv implementimi i SharePointit në procesin e përditshëm të punës

2: A është SharePointi i dizajnuar që të adresojë në mënyrë të sukseshme bashkpunimin në institucionit publike

3: A do mund stafi administrativ dhe mësimorë të adoptojë lehtësisht procesin e punës në Intranet

## Metodologjia kërkimore:

Në përpilimin e studimit janë adoptuar metodat kërkimore të më poshtme:

**Rishikim i literaturës:** Qëllimi kërkimor i studimit është implementimi i intranetit nëpërmjet SharePointit, dhe analizimi i përgjigjeve të përdoruesve përbrenda Intranetit, andaj shumica e literaturës së përdorur janë botimet nga Mikrosfti (Pasi që SharePointi) është produkt i mikrosftit, si dhe i botimeve në revista të ndryshme shkencore të cilat janë cituar përgjat studimit.

**Analizat Kuantitative:** Përgjigjet e grupit të përdoruesve, dhe testuesve të parë të platformës së implementuar do të adresojnë adoptimin e SharePointit, dhe do të ndihmojnë në përmirësimin e mëtutjeshëm të tij. Pyetsori është përpiluar në mënyrë që subjektet të japin sa më shumë detaje, në mënyrë që të kemi rezultate të matshme për përmirësim të mëtutjeshem.

**Analizat Kualitative:** Rezultatet e grumbulluara të pyetësorit të lartëpërmendur do të komentohen, dhe rezultatet do të jenë në kapitullin e fundit të studimit

**Implementimi i studimit:** Implementimi i SharePointit është në fokusin e studimit, një pasqyrë e qartë e mënyrës se si është implementuar do të paraqiet përgjat studimit.

## Teknologjitë e shfrytëzuara:

Microsoft SharePoint: Platformë e mikrosoftit që shfrytëzohet për krijimin e faqeve për përdorim të mbrendshëm, platformë që mund të organizojë, ndajë, dhe të ofrojë akses në informacione nga çdo pajisje. Mundëson dhe inkurajon bashkpunimin dinamik në grup, dhe web-sajte interne për çdo departament, dhe divizion në hartimin e projekteve. Ndarja e dokumenteve, lajmeve, dhe resurseve në forma të ndryshme dhe në hierarki të ndryshme. Kostumizim i mënyrës së punës, dhe bashkpunim efikas dhe të sigurt përbrenda dhe jashtë institucionit. Ndërtimi i kohezionit dhe informimi i punonjësve përbrenda intranetit mundëson që procesi i punës të shkojë në kahjen e duhur, duke i dhënë institucionit efikasitet, dhe duke ndarë resurset në faqet e brendshme të intranetit, mundësia e bashkpunimit përbrenda ekipit nëpërmjet sajteve të komunikimit shton efikasitetin e bashkpunimit. Në versionin e ri të sharepointit dhe algortimin e kërkimit të ri, në mënyrë të lehtë arihet deri te informacioni, dhe ekspertiza e duhur. Menaxhimi i kontentit së bashku me ndërlidhjet tjera dhe integrimi i “Yammerit” mundëson komunikim në kohë reale, dhe ndërveprimin në mes antarëve të intranetit. Procesi i transferimit të punës, dhe aprovimi i detyrave komplekse gjithashtu mund të arihet përbrenda SharePointit nëpërmjet Microsoft Flow, dhe PowerApps të cilat integrohen në SharePoint, dhe krijojnë një ambient të pasur dixhital nëpërmjet formave, “work-flows’ dhe aplikacioneve të kostumizuara.[47]

Microsoft PowerApps: Shumësi aplikacionesh, servises, dhe platformash të dhënash që mundëson zhvillim të shpejtë aplikacionesh për nevojat e ndryshme e organizatës. Duke shfrytëzuar Power apps mund të zhvillojmë aplikacione në mënyrë të shpejtë për nevojat e institucionit, të ndërlidhimin të dhënat e institucionit me të dhëna të jashtme për nevoja vetanake, gjithashtu ndërlidhja mund të bëhet edhe në mes shërbimeve të ndryshme të mikrosoftit (SQL, Dynamics 365). Aplikacionet e zhvilluara me powerApps imponojnë një logjikë të pasur biznesore, dhe mënyre pune dinamike, kjo mundëson transferimin e procesit manual të punës, në atë dixhital dhe të automatizuar, gjithashtu aplikacionet e ndërtuara me PowerApps kanë dizajn responsiv ( Responsive Design) dhe përshtaten me dimensionet e ndryshme të browserave në pajisje të ndryshme (telefon, ose tablet). Power Apps “demokratizojnë” zhvillimin e aplikacioneve të kostumizuara duke ju mundësuar përdoruesve të ndërtojnë në mënyrë të lehtë aplikacione të pasura dhe me ndërveprim kompleks, pa nevojën e shkrimit të kodit. Po ashtu powerApps mundëson zgjerimin në platformë nga e cila mund të programohet, dhe zhvilluesit mund të ndërveprojnë me të dhëna, krijojnë ndërlidhje logjike, të zhvillojnë logjik biznesore

përmbrenda aplikacionit, dhe të ndërveprojnë me të dhëna nga jashtë. PowerApps ofron tre modele të aplikacioneve: “Canvas”, “Model-Driven” dhe “Portal” . Nëpërmjet PowerApps Studio dizajnohet aplikacioni me të dhëna të gatshme. Model-Driven mundëson krijimin e një aplikacioni duke shtuar komponentë të gatshëm për ndërtimin e tij. Portal Studio mundëson dizajnimin dhe shtimin e web-sajteve përmbrenda aplikacionit, duke mundësuar krijimin e komponentëve të gatshëm, formave, dhe listave. [45]

Microsoft Yammer: Yammer është platformë komunikimi që rekomandohet nga mikrosfti për përdorim të mbrendshëm në Intranete, ndarje të ideve, diskutim dhe ndërveprim përmbrenda organizatës, përpos komunikimit yammer është edhe vegla e cila mundëson bashkpunimin frytdhënës në institucion nëpërmjet veçorive të tij si: “Join a community” veçori e cila mundëson ndërlidhje me grupe të veçanta pune përmbrenda organizatës duke mundësuar informimin në kohë reale, mbledhje përmbrenda grupit, dhe ndarje të ideve. “Participate in the the conversation”, mundësi pëlqimi, reagimi dhe ndarje e mesazheve qoftë brenda grupit ose në të gjithë organizatën, ose targetim individual nëpërmjet “@”, gjithashtu ndarja e dokumenteve në mënyrë të shpejtë pa pasur nevojë të gjurmoni përmbrenda intranetit. “Enhance your Yammer Profile” mundëson njohjen me pjesën tjetër të punonjësve nëpërmes kartës së njohjes, Yammer profile gjithashtu përdor informacionin publik për krijimin e lidhjeve të rreja dhe ndërtimin e një rrethi të fuqishëm. Përdorimi i inboskit për filtrimin dhe prioritet të mesazheve, njoftimeve është gjithashtu mundësi për inkuadrin dhe qasje në informacion. Në Yammer egzistojnë disa lloje të mesazheve, gjë e cila e bën komunikimin më të lehtë, dhe më frytdhënës, polls, crowdsourc, dhe feedback janë llojet e mesazheve të cilat marinformacionin e duhur në lidhje me çështje të ndryshme. Yammer gjithashtu mund të meret si aplikacion në vete në celularë. [48]

Google Analytics: Platformë e zhvilluar nga Google për analizim të dhënash, dhe dhënje të rekomandimeve për vendimmarje përmbrenda webit. Ndërtimi i një pikturë të plotë përmbrenda përdoruesve të sajtit, dhe vlerësimin i performancës së konsumatorëve përmbrenda aplikacionit apo web-faqes. Google Analytics është e ndërtuar në mënyrë që të bashkverpojë me departamentin e marketingut të google, në mënyrë që analiza e cila vjen nga “Google Analytics” të japë rezultate sa më të sakta për sjelljen e përdoruesve në Web. Procesimi dhe ndarja e të dhënave në mënyrë të shpejtë dhe pa vonesa. Duke përdorur mundësitë e “Machine Learning” të Google, Google Analytics mundëson vlersime të veçanta nga të dhënat e mbledhura, duke propozuar se cili nga përdoruesit mund të bëjë abonim, ose se cili nga përdoruesit ka potencial për shpenzime të mëdha. Analizimi i shpejtë i të dhënave dhe inkurajimi për bashkpunim, si dhe “Interface” që është lehtë i përdorueshëm mundëson ndarje të shpejtë të të dhënave nëpërmjet



konfigurimit të API-së së Google, në mënyrë që procesi të jetë fleksibël dhe i programueshëm. Google Analytics gjithashtu ofron suport teknik, dhe infrastrukturë globale. Veçori thelbësore e Google Analytics është segmentimi, vizualizimi dhe monitoringu, si dhe analizat e avancuara. Të dhënat e mbledhuara mund të vizualizohen në mënyrë të kapshme për përdoruesin apo bordin menaxherial, dhe nga to të nxirren konkluzat për mbarëvajtjen e biznesit. [44]

Microsoft Powershell: Platformë komandash që automatizon procese, dhe ofron zgjidhje nëpërmjet kodit, shfrytëzohet për ndertim të aplikacioneve, testim dhe plasim të tyre, gjuha programuese që egzekuton komandat në shell është “Scripting language” dhe është e bazuar në .NET. Shelli është platformë moderne komandash e cila përmban veçori të ndryshme të automatizimit, shumica e gjuhëve skriptuese pranojnë ose refuzojnë tekst, Powershelli mundëson pranimin dhe refuzimin e objekteve në .NET. Powershelli përmban veçoritë e më poshtme si: Histori e komandave të përdorura, plotësim i komandave dhe sugjerim i komandave të shkruara, mundëson parametrave të komandave, mundëson manipulim të “pipeline” me anë të komandave zinxhore, ndihmë përmbrenda konsolës e ngjajshme me Unix man faqet. Si gjuhë skriptuese Powershelli zakonisht përdoret për automatizimin të sistemit të menaxhimit, gjithashtu përdoret për zhvillim, testim, dhe plasim të zgjidhjeve, më së shpeshti në ambiente CI/CD. Powershelli është i ndërtuar në .NET Common Language Runtime (CLR). Të gjitha inputet dhe outputet janë objekte.NET, andaj nuk duhet të parafrazohet komanda për nxjerrjen e informacioneve në output. Gjuha skriptuese e Powershellit ka veçori të jetë e zgjeruar në funksione, klasa, skripta, dhe module, ka veçori që të zgjerohet në sisteme formatimi për nxjerrjen e lehtë të outputit, mbështet të gjitha formatet e të dhënave si CSV, JSON, dhe XML. Në konfigurimin e menaxhimit PowerShell Desired State Configuration mundëson krijimin e konfigurimeve deklarative dhe skriptave të personalizuara për nevojat përsëritëse, për zhvillimin e raporteve, si dhe konfigurimin nëpërmjet push dhe pull modeleve. [46]

Html: HyperText Markup Language është standarti i gjuhës së dizajnuar për publikimin e dokumenteve në “Web Browser. Web Browseri e mer dokumentin HTML nga web serveri ose nga disku lokal dhe renderon atë si multimedia web-faqe. HTML përshkruan strukturën e web sajtit në mënyrë semantike dhe tregon gjurmë për aperancën e dokumentit. Elementet e HTML-së janë blloqet ndërtuese të faqeve HTML. Me anë të HTML konstruktoreve mund të renderohen imazhet dhe objektet tjera si forma interaktive. HTML gjithashtu jep mundësinë e krijimit të dokumenteve të stukturuara duke përdorur semantikën strukturore për tekstet si paragrafi, lista,

linqet, kuotat. Elementet e HTML-së cilësohen si “tags” të shkruara në mes kllapave “<>” si “<input>”. Në HTML gjithashtu mund të plasohen linja kodi të shkruara në gjuhë skriptuese si Javascript, gjuhë e cila e ndryshon sjelljen e web-faqes dhe përmbajtjes së sajë. HTML markup konsiston në disa elementë kyç të ashtuquajtuara “tags” që në brendi janë lloj i të dhënave të shkruara nëpërmjet shkronjave, shumica e “tags” në html janë në çifte si <h1> dhe </h1>, ndërsa një pakicë janë si elemente bosh, dhe nuk janë në çift shembull <img>, “tag” i parë konsiderohet si startuesi, ndërsa i dyti konsiderohet si “tag” i përfundimit. Komponenti tjetër i rëndësishëm në HTML është deklarimi i tipit të dokumentit gjë e cila sjell standartin në HTML. Standarti i fundit i HTML-së është HTML 5 i cili deklarohet në fillim të dokumentit me anë të “tag” <!DOCTYPE html>, në qoftë se deklarimi i më sipërm është browser të ndryshëm do ta mundohet që ta konvertojnë dokumentin në formë të kuptueshme për përdoruesin.[16]

CSS: Cascading Style Sheets është gjuhë që stilizon dokumentet e paraqitura në HTML. CSS konsiderohet si bazë e ndërtimit të webit modern së bashku me HTML, dhe Javascript. CSS është dizajnuar në mënyrë që të mundësojë ndarjen e prezentimit nga përmbajtja, duke mundësuar që teksti të ketë dimensione, ngjyra, dhe fonte të ndryshme. Kjo ndarje mundëson fleksibilitet më të madh dhe kontroll të prezentimit të karakteristikave të web-faqeve, duke mundësuar që disa web-faqe të ndajnë veçori të përbashkta në dokumente të ndryshme të CSS, gjë e cila thjeshtëzon kompleksitetin dhe përsëritjen në përmbajtjen stukturore, dhe mundëson dokumentin CSS të bëhet “cached” gjë e cila mundëson shpejtësi më të madhe të hapjes së sajtit. Ndarja e formatimit dhe kontetit mundëson që një sajt të presentohet në stile të ndryshme të renderimit, si përshembull në ekran, në brill kod, dhe në ekrane më të vogla. Sintaksa e CSS është në gjuhën angleze dhe përdor një fond fjalësh të rezervuara për targetimin e elementeve të ndryshme, dhe i konsideron ato si regulla, çdo regull konsiston në një apo më tepër selektorë dhe një bllok deklarimesh. Në CSS selektorët deklarojnë se cila pjesë e dokumentit HTML do të ndryshojë pamje. Selektorët mund të aplikohen në të gjitha elementet, si dhe në të gjitha elementet që kanë attribute të veçanta si klasa, dhe id.[10]

TypeScript: Gjuhë “open source” e bazuar në JavaScript që definojnë formën e objektit duket shtuar definime statike në të. Types mundëson një mënyrë që të përshkruhet forma e një objekti, duke ofruar dokumentimin më të qartë dhe duke lejuar që TypeScript të validojë se kodi i shkruar nga përdoruesi punon. Shkrimi i “Types” është opsional në TypeScript nga që “type-inference” mundëson fuqi më të madhe duke shkruar më pak linja kodi. I gjithë kodi valid i JavaScript është gjithashtu kod në TypeScript, mund të ketë gabime të vogla në sistaks gjë e cila nuk e pamundëson kompilimin e kodit, edhe pse mund të ketë ambient strikt të shkrimit të kodit, kjo

nuk e ndalon kompilimin e tij. Transformimi i kodit të JavaScript-it në TypeScript bëhet nëpërmjet Babel. Kodi i transformuar është i qartë dhe vepron në çdo ambient ku vepron JavaScripti. Me anë të TypeScript mund të zhvillohen aplikacione të JavaScript për anën e klientit dhe anën e serverit. Standarti i TypeScript është i njëjti me atë të Javascript dhe në versionin e fundit të tij janë inkuadruar klasat, modulet, shkurtesat, dhe parametra të tjerë opsional.[19]

## Hulumtimet e deri më tanishme

Implementimi i një sistemi të menaxhimit në botën e biznesit dhe korporatave i ka filluar në dekadën e më parshme, duke marrë shtysë nga kjo institucionet publike në rajon, por edhe në vendin tonë aplikojnë sisteme menaxhimi të ndryshme në mënyrë që produktiviteti dhe menaxhimi i procesit të punës të jetë sa më efikas, dhe rrjedhoja e punës të jetë lehtë e menaxhueshme, por edhe ngecja të jetë e tejkalueshme me pasoja sa ma të vogla. Gjatë kërkimeve për implementimin e SharePointit, rastet e studimit në korporata japin një pasqyrë të qartë të asaj se si volumi i punës, dhe menaxhimi i sajë me anë të SharePointit thjeshtësohet, në dhjetëvjeçarin e fundit SharePointi adaptojnë metoda bashkohore të menaxhimit duke u fokusuar në metodologjinë agile të funksionimit. Menaxhimi me anë të SharePointit në botën e biznesit zë një përqindje të madhe të tregut të sistemeve të menaxhimit, i njëjti në institucionet publike sapo ka filluar të japë rezultatet e para. Në pjesën kërkimore të asaj se sa efektiv është SharePointi janë cituar pesëmbëdhjetë punime shkencore të botuara në revista të ndryshme, shumica e të cilave flasin për efektet e implementimit të SharePointit, si ndikon implementimi i SharePointit në ndarjen e dijes, aftësitë e SharePointit për rritjen e produktivitetit në kompani të mesme dhe të vogla, pikat takuese të SharePointit dhe inteligjencës artificiale. Në disa studime theks i veçant është në teknikat e implementimit të SharePointit në institucione arsimore të larta, si dhe në kompani shtetërore me numër të madh punonjësish. Hulumtimet e deri më tanishme konsistojnë në pesëmbëdhjetë punime shkencore të botuara pesë vitet e fundit, dhe pesë libra të cilët fokusohen në teknikalitete dhe metoda të implementimit. Theks të veçant në përpilimin e këtij punimi, ka botimi i realizuar për implementimit e SharePointit në një institucion me numër të lartë punonjësish në një vend fqinj, ku tregohet metoda, infrastruktura e cila është përdorur, arkitektura e zhvillimit të portalit dhe efektet e implementimit. Hulumtimet gjithashtu tregojnë një ngritje në përmasa globale të përdorimit të SharePointit si dhe efekte lehtësuese të procesit të punës.

Në librat të cilat janë cituar jepen modele të gatshme të aplikacioneve të cilat integrohen përbrenda SharePointit, si dhe zgjidhje të problemeve që mund të hasen në etapat e mëtejshme të përdorimit të SharePointit, të cituara janë edhe linjat e kodit të cilat janë

implementuar përgjat zhvillimit të portalit, dhe teknikat e implimentimit të dhëna nga faqet ndihmëse të mikrosoftit dedikuara për SharePoint.

Botimi i më poshtëm është realizuar përgjat pandemisë, në momentet kur prezenca fizike nuk ishte opsion, sidomos në vendet me numër të madh punonjesisht, është koherent, dhe jep rezultate të qarta në lidhje me aftësinë e SharePointit në menaxhim të procesit të punës. Studimi i botuar në “Journal of Digital Imaging” me autorë “Corey J. Hiti, Jennifer Chang, Kriti Gwal, Eva Escobedo, Margaret Rea, Jasjeet Bindra” me titull “The new normal: Coronavirus Pandemic Response Utilizing Microsoft SharePoint” (“Normalja e re: Përgjigja ndaj pandemisë duke shfrytëzuar Microsoft SharePointin”), në analizën e bërë për mbarëvajtje të procesit edukativ në stafin dhe studentët e programit të mjeksisë, duke respektuar normën e re të distancimit social, janë vlerësuar punonjësit në institucion në përpjekjen e tyre që të shëndrojnë aktivitetet e tyre edukative në një format online, me qasje nga jashtë duke shfrytëzuar platformën e Microsoft SharePointit. Në studim morën pjesë 26 pjesëmarrës, nga ku 92.3% e karakterizuan platformën e SharePointit si të dobishme, po të njëjtët potencuan se përdorimi i SharePointit sjell ndjesinë e të punuarit në një komunitet të përbashkët. Përcetimi i përgjithshëm i punonjësve për përdorimin e SharePointit si platformë bashkpunuese është pozitiv, dhe ndihmon në zbutjen e pasojave dhe mangësive që shkaktojnë pandimia në procesin edukativ. [7]

Implementimi i më poshtëm i SharePointit në institucione publike, qartazi tregohet në botimin e më poshtëm, si manual për realizimin e implementimit në institucionin ku aplikohet SharePointi është shfrytëzuar punimi i më poshtëm, arkitektura dhe metoda e realizimit janë në përputhje me guiden e mikrosoftit për implementimin e SharePointit. Në studimin e botuar në “Journal of Universal Excellence” me autorë “Dragan Dokic, Marijana Despotavic Zrkaic, Zorica Bogdanovic, Aleksandra Labus” me titull “Application of SharePoint portal technologies in public enterprises” (“Aplikimi i SharePointit në kompanitë publike”) e potencon nevojën e sistematizimit të platformave menaxheriale në kompani të ndryshme, si dhe në sektorin publik; duke

shfrytëzuar teknologji të ndryshme dhe servise “cloud” për të aritur përdorueshmëri më të gjërë, qasje në kohë reale, dhe gjithëpranueshmëri të shërbimeve. Studimi i bërë aplikohet në postën e republikës së Serbisë, dhe qëllimi është të arihet efikasitet në shpërndarjen e informatave në gjitha nivelet hierarkike. Sipas Gartnerit nga kompania Gartner ka rreth 300 milion instalime të Excelit, 200 milion PDF dokumente, dhe rreth 100 milion dokumente të Microsoft Office të gjeneruara çdo ditë, Gartner gjithashtu shpjegon se të dhënat e pastruara, gjysëm të strukturura, dhe ato komplekse, gjithnjë e më tepër janë të përhapura në shërbimet e orientuara (Service oriented), skenar i cili kërkon transformim të sistemit të shpërndarjes së të dhënave përmbrnda kompanive, dhe i njëjti duhet që të kodohet nga fillimi (Coded by hand). Në studim potencohet se për të analizuar kualitetin, qasjen, dhe relacionin në mes të dhënave, duhet analizuar tre segmente kryesore të integritit të shërbimit, si: Integrimi I kompanisë, SaaS (Software as a service), dhe B2B (Business to Business) ndarja e të dhënave në mes partnerve të biznesit. Gjatë implementimit të SharePointit në studim, arkitektura e përdorur për bashkpunim është

	si		më		poshtë:
Administrimi			i		portalit
Mekanizmi	për	qasje	në	të	dhëna nga jashtë
Shërbimi	për	menaxhimin	e	të	dhënave
Siguria,		autentikimi,		dhe	personalizimi
User		Interface			Management
Web interface					

Arkitekturë tradicionale e një portalit të webit që ngërthen në vete burimin e të dhënave, qasjen në të dhëna nga jashtë, shërbime për menaxhimin e të dhënave, sigurinë dhe personalizimin. Në përfundim të studimit autorët konkludojnë se aplikimi i SharePointit ka ndikuar në transformimin e procesit të biznesit, në standartizimin e tij si dhe në ndryshimin e strukturës organizative përmbrnda kompanisë. [11]

Krijimi i një baze të dhënash për ndarjen e diturisë është sfidë edhe sot, punimi i më poshtëm jep një model të paracaktuar se si implementimi i SharePointit mund të ndihmojë, në të njëjtën kohë

teston limitet dhe mundësitë e SharePointit në krijimin e databazës për ndarjen e dijes .Studimi i botuar nga autorët “Allie Lustigman” dhe “Amy Hanley” nga “Cambridge University Press” me titull “Creating a knowledge database in SharePoint: Testing the boundaries” ( Krijimi i një baze të dhënash për informacionin: Testimi i mundësive dhe limiteve” autorët implementojnë dhe testojnë databazën e informacioneve (database knowledge) me resurse të limituara dhe kohë të limituar, duke potencuar se SharePointi është user friendly (I lehtë për tu përdorur) dhe funksional, nuk ngelet pas sa i përket ndihmës që ofron për bashkpunim, siteve dinamike, dhe kërkimit të dokumentave, si dhe rikthimin e tyre. Përgjat realizimit të projektit autorët ishin të preokupuar me pyetjen se a do përdorej SharePoint inga punonjësit, por gjithashtu ishin të bindur se në qoftë se i njejt përdoret deri në limitet e tij të skajshme, ka potencial të jetë system menaxhimi frytdhënës. Problemi që hasën autorët ishte se SharePointi nuk i plotësonte kërkesat nga këndvështrimi i pordoruesit. Nga biseda analizat e bëra, dhe pyetsorët erdhën në përfundim se duhej një sistem i cili ishte lehtë i përdorueshëm(Krahasimi bëhet me google), por nuk mund të replikohej “Google” me teknologjinë që kishin në dispozicion, por duhej të krijohen një database që përdoruesi të kishte të lehtë përdorimin përmbrnda SharePointit. Në konkluzat e nxjera nga kërkimi, dizajnimi, dhe implementimi i sistemit të SharePointit dhe rëndësisë së tij për funksionim ishte se profesionistët duhej të kishin informata jo vetëm në front-end, por edhe ne back-end. Implementimi i sistemit ishte një “eye-opener” në zhvillimin dhe kuptimin e shtresave të ndryshme, të një softueri bazik dhe asaj që përdoruesi sheh. [1]

Një nga rastet më të kapshe të implementimit të SharePointit në institucione publike është ai i implementimit të tij në institucione mjekore, ku menaxhimi duhet të jetë preciz, dhe në të njejtën kohë sistemi menaxhues luan një ndër rolet më të rëndësishme të funksionit të qendrës mjekore. Studimi i më poshtëm hedh dritë mbi atë se cilët janë efektet e SharePointit në këtë institucion. Studimi i botuar në revistën “Management in health” nga autorët “Haman Althagafi” dhe “Tahani Daghistani” me titull “The roadmap for using sharepoint to enhance organization and management functions: Healthcare organization-case study” (“Udhëzim për përdorimin e sharepointit në mënyrë që të ritet funksioni organizativ dhe menaxherial i organizatës”), autorët potencojnë nevojën për sistematizim të të dhënave në mënyrë që vendimarrja të bëhet në bazë

të informatava që ndodhen përbrenda sistemit. ECM( Enterprise Content Management), janë të dizajnuara për menaxhimin e informacionit në mënyrë sa më të mire, SharePointi në veçanti mund të zgjidh probleme të shumta përbrenda organizatës, duke filluar nga humbja e të dhënave, proceset e përritshme që marin kohë, komunikim i zbehtë përbrenda stafit sidomos në hapsira që s'janë fizikisht afër. Objektivat e studimit ishin që të jepet një zgjidhje empirike për pordorueshmërine e SharePointit, për ruajtjen e të dhënave, sistematizimin, manipulimin, si dhe përcjelljen e informacionit. Metodot e mbledhjes të dhënave ishin nga disa burime, duke përfshirë edhe një pyetësorë online, më pas një model i gatshëm u prezentua nga kërkuesit që demonstronte realisht aktivitetet të cilat kryente SharePointi. Përdorueshmëria e SharePointit u fokusua në tre komponentë si atë: Document Management, SharePoint Workflow, dhe Business Intelligence. Nga implementimi dhe rezultatet e përpunuara u konstatua se implementimi i SharePointit ndihmonë aktivitetet e përditshme të organizatës, dhe stimulon bashkpunimin, dhe përgjegjësinë në ambient pune. [15]

Metodologjia e punës agile, ofron dinamikizëm dhe rezultate të shpejta në projekte ku marin pjesë numër i madh departamentesh, në studim autorët testojë zgjidhjet e zhvillimit të SharePointit me anë të metodave testuese, analizojnë se a i përmbush kushtet SharePointi në menaxhimin e projekteve softuerike, dhe a është i përshtatshëm. Studimi i botuar në “ International Journal of Computer Sciences and Engineering” nga autorët “Madhu Dande dhe Neelima Galla” me titull “Automation Testing Frameworks for SharePoint application” autorët testojnë kornizën e punës së automatizuar ( Automation Framework ) për migrimin e sharepointit për organizatat me numër të lartë punonjësish. Duke analizuar të gjitha fazat që të detektojnë defektet(bugs) në fillimet e planifikimit të zhvillimit të softuerit (Software Development Lie Cycle-SDLC), meqë organizatat punojnë në dy modele kryesore për zhvillimin e softuerit(Waterfall dhe Agile), dhe kohës se fundit ka një prirje reth metodologjisë Agile, fazat e më poshtme të testimit janë bërë para se të fillojë zhvillimi: Unit integration dhe System and User Acceptance, sistemi i përzgjedhur i testimit do të jetë Selenium/QTP. Gjatë procesit të zhvillimit të aplikacionit nëpërmjet metodologjisë Agile në fazën e testimit të Unit Integration janë testuar komponentët e më poshtëm:



Functional dhe GUI ( Uniform style Implementation, Custom grids and navigations, Branding Schemes), Search(Search Relevance, Cross site Search, Search Admin and Management), Integration(Search Integration, Notification Integration, Web Services), Core Services(Site templates, Alerts, Navigation), Personalisation (Site and role management, Auditing Services, Policy Management Services), Business Process and Forms( Browser based forms, centralized forms, business data features), Collaboration ( Email and Calendar, Document Collaboration, Issue Tracking), dhe Business Intelligence ( Dash Boards, Data Connection libraries, Excel Services ), të gjitha komponentët e lartpërmendur janë analizuar, zhvilluar dhe testuar nga seleniumi. Nga testimi i komponentëve të mësipërme është aritur në përfundim se nga testimi i bërë ka pasur benefite financiare në vlerë 50% të shumës së investuar fillimisht.[22]

Dizajnimi i faqeve të SharePointit edhe pse është në të shumtën e kohës skematik, përdor skema të ofruara nga Mikrosfti, egziston edhe mundësia e dizajnit të faqeve përbrenda portalit nëpërmjet SharePoint Designer, SharePoint designer nuk është vetëm mjet dizjani, në të njëjtën kohë ai dizajnon edhe procesin e punës dhe etapat në të cilën puna duhet të kalojë. Studimi i botuar nga “Madhu Seles” dhe “Vivela Priya” në revisten”International Journal of Emerging Technologies in Engineering Research” me titull “Survey – Sharepoint Workflow using SharePoint Designer” (Procesi i punës në SharePoint duke përdorur SharePoint Designer) autorët japin një pasqyrë të qartë të implementit të sharepoint sistemit, duke potencuar se gjatë procesit të punës në organizata të ndryshme dhe aktivitetëve të tyre ditore, procese të ndryshme të teknologjisë informative shfrytëzohen, dhe kjo është pjesa ku SharePointi futet në përdorim. Autorët fokusohen në aplikacionin WorkFlow në kuadër të SharePointit dhe potencojnë dobitë dhe aftësitë e procesit të automatizimit të punës në kuadër të WorkFlow aplikacionit, Workflow aplikacioni shërben si aplikacion i veçantë dhe i mëvetshëm dhe mund të plasohet (hosted) përbrenda aplikacionit ose jashtë tij. Si veçori të workflowit janë implementuar shërbimet e mëposhtme: High Density and Multi-Tenancy, (Veçori e workflowit), Elastic Scale, Activity/Workflow Artifact Management, Tracking and monitoring, Instance Management, Fully

Declarative Authoring, Rest and Bus Service Messaging, dhe Managed Service Reliability. Në përfundim autorët potencojnë fleksibilitetin e SharePointit për zhvillim të shpejtë të faqeve të ndryshme përbrenda aplikacionit, faqeve bashkpunuese, faqeve listuese, dhe të gjitha veçorive që i ofron Windows SharePoint Services (Versioni 2013). [23]

Intraneti si sistem komunikimi më së miri identifikohet me SharePointin, vështirësi më të madha në përdorimin e Intranetit ndodhin në momentin kur ka konsulentë të jashtëm të cilët nuk kanë qasje në dokumentat arkivorë përbrenda sistemit të dokumenteve të një kompanie. Studimi i më poshtëm hedh dritë në atë se si implementimi i SharePointit mundëson qasje të konsulentëve të jashtëm në procesin e punës përbrenda kompanisë. Studimi i botuar nga “Eli Hustad” dhe “Thomas Vikstol” në revistën “Procedia Technology” në vitin 2014 me titull “Implementing Intranet 2.0: A study of knowledge requirements for external consultants in enterprise systems” (“Implementimi i intranetit 2.0: Studim për kërkesat e informatave për konsulentët e jashtëm në sistemet e kompanive”) autorët analizojnë implementimin e SharePointit nga thjerrëza e konsulentëve të jashtëm, ku potencojnë se projekti për implementimin e SharePointit është i shoqëruar nga kërkesa të komplikuar socio-teknike, dhe kërkon në disa raste edhe ndryshim të strukturës organizative përbrenda organizatës. Studimi fokusohet në implementimin e projektit dhe rolet e konsulentëve të jashtëm në implementimin e intranetit nëpërmjet SharePointit. Të përzgjedhurit për analizë, nxorën disa pika ku SharePointi përbrenda organizatës duhet të ketë theks të veçant, si vijon:

- System development and changes in the system architecture
- Customization of SharePoint projects
- Project management in SharePoint projects
- Development of requirement specification and preparation of system solutions
- Managing user expectations
- Integration of SharePoint with legacy systems and related configuration
- System architect – developing the system architectural solution

Autorët theksojnë gjithashtu se të personalizosh një zgjidhje në SharePoint është e komplikuar dhe në shumë raste jo-efektive, sepse e njëjta duhet të mirëmbahet në të ardhmen, gjithashtu

ata potencojnë se implementimi i sharepointit e standardizon procesin e punës në organizatë.[12]

NëMeqë SharePointi si platformë bazohet në cloud, dhe shumica e shërbimeve moderne janë të bazuara në cloud, një ndërthurje e sistemeve në cloud dhe atyre lokale japin rezultate të favorshme në menaxhimin e punës. Sistemet e bazuara në ndërthurjen e cloudit dhe asaj lokale janë avantazh për organizatat dhe institucionet, të dhënat nga njësia lokale mund të integrohen në cloud në mënyrë të automatizuar nëpërmjet SharePointit. Studimi i më poshtëm i botuar nga “Signe Balina”, “Dace Baumgarte”, dhe “Edgars Salna” në “Procedia Computer Science” me titull “Cloud Based Cross-System Integration for Small and Midium-Sized Enterprises” (“Integrimet e sistemeve të bazuara në cloud për organizatat e mesme dhe të vogla”), autorët analizojnë implementimin e sistemit të shërbimit të informatave të kombinuara me sisteme për procesimin e biznesit që së bashku shërbejnë në kryerjen e detyrave të organizatave. Në përshkrimin e implementimit të SharePointit, ata theksojnë se SharePointi mund të implementohet si shërbim cloud, dhe përfshin një shumëllojshmëri të shërbimeve të bazuara në REST, SOAP, dhe Odata gjë e cila siguron funksionalitetin në cloud. Integrimi i të gjitha shërbimeve në cloud presupozon se çdo sistem ka një API për integrim të sistemit, në studim shërbimi i marrë në këtë rast SharePointi ka një shumëllojshmëri shërbimesh që siguron komunikimin e sistemit me përodruesin, ndërsa shkembimi i dokumenteve si bazë për komunikim mund të përodrret gjithashtu. Pjesa tjetër e rëndësishme e zgjidhjes për integrim të shërbimit është mundësia e ndjekjes së ndryshimeve përbrenda sistemit të menaxhimit, sistemi i integruar duhet të dijë kur ka ndryshime në rrjedhjen e punës, dhe të marrë informatat, e të njejtat ti plasojë në sistemin e menaxhimit. Bërthama e integrimit të shërbimeve konsiston në dy veçori, në implementuesit e sistemit të informatave, dhe kordinimin e itegrimit. Në përfundim autorët potencojnë se meqë organizata të ndryshme kanë tendencë për shfrytëzimin e sistemeve të ndryshme për menaxhimin e informatave, kompleksiteti i kordinimit të këtyre është e vështirë edhe pas integrimit në cloud [40]

Rast i zbatimit të SharePointit në institucione publike, ku sensitiviteti i të dhënave është i lartë paraqitet në studimin e më poshtëm të auditëve në shtetin Rumun. Implementimi i SharePointit mundëson që auditët të ndajë të dhënat konfidenciale, dhe të njejtat të gjurmohen nga superiorët e tyre, në mënyrë të lehtë dhe të kapshme. Studimi i realizuar nga “Nastase Pavel, Lucian Cristian” në vitin 2015 me titull në revistën “Amfiteatru Economic Journal” me titull “Developing an online collaborative system within the domain of financial auditing” (“Zhvillimi i një sistemi bashkpunimi online në fushën e auditimit financiar”) autorët fokusohen në aspektin teknik të zhvillimit të platformës, ku si qëllim kanë zhvillimin e një sistemi i cili u mundëson bashkpunim auditëve, dhe investigon se si një platformë e zhvilluar në SharePoint mund të inkorporohet në databzën nacionale të auditëve, për zhvillim të shpejtë të platformës autorët përdorin Microsoft SQL Server 2008 R2, SharePoint Server 2010, dhe Sharepoint Designer 2010, gjithashtu edhe disa shërbime të tjera eksterne të webit. Në procesin e implementimit të databases autorët në aspektin teknik e dizajnojnë sistemin në gjashtë faza, si vijon:

Faza 1: Dizajni konceptual dhe logjik i databases së auditëve  
Faza 2: Krijimi i kontetit të jashtëm nëpërmjet SharePoint Designerit  
Faza 3: Definimi i parametrave që mbështesin manovrimin, dhe vendosja e filtrave  
Faza 4: Krijimi i listave të jashtme për cdo lloj të jashtëm të informatave  
Faza 5: Krijimi i lidhjeve për kontentin e jashtëm  
Faza 6: Krijimi dhe marrja e raporteve online për të gjithë auditët, dhe punonjësit

Në zhvillimin e platformës SharePoint, dhe dizajnit të databases, tre hapa janë ndërmarë në dizajnimin e databases: Dizajnimi konceptual i databases, dizajni logjik i databazës, dhe dizajnimi fizik. Më pas gjatë prezentimit të prototipit, në fazën e parë është prezentuar dizajni logjik dhe konceptual i platformës SharePoint të auditëve, krijimi i kontetit të jashtëm nëpërmjet SharePointit, Definimi i operacioneve (parametrave) ku autorët kanë implementuar operacionet CRUD(Create,Read,Update,Delete), krijimi i listave të jashtme, Krijimi i lidhjeve për kontentin e jashtëm, ku autorët lidhjen me kontentin e jashtëm e cilësojnë si BSC(Business Connectivity Services), dhe i cili mundëson relacione në bazë të *foreign key*, dhe krijimin dhe marrjen e raporteve online. Studimi konkludon se krijimi i një portali SharePoint për audit është i

mundshëm, dhe i realizueshëm, si dhe inkorajon transparenë përmbrnda auditëve në shtetin Rumun. [30]

Sfidat e projektimit në grup, sidomos ato në grupe të disperzuara dhe jo gjeografikisht në hapsirën e njejtë janë të mëdha, ambienti dixhital për mbarëvajtje të projekteve është i rëndësisë jetike, sa i përket menaxhimit të projekteve, studimi i realizuar analizon mënyrën se si ambienti dixhital i bazuar në SharePoint ndihmon në organizimin e projekteve në studentet e ciklit të lartë në universitet. Studimi i realizuar nga “Olena Glazunova, Olena Kuzminiska, Tetyana Voloshyna, Taisia Sayapina, Valentyna Kolchuk” në vitin 2017 me titull “E-Environment based on Microsoft sharepoint for the organization of group project work of students at higher education institutions” (“E-ambient i bazuar në sharepoint për organizimin e projekteve në grup, për studentet në institucionet e larta arsimore”). Në studim zhvillohet, dhe implementohet një platformë e bazuar në cloud për trajnimin e studentëve të fakultetit të shkencave natyrore, dhe diskutohen avantazhet e aplikimit të një ambienti bazuar në SharePoint. Gjithashtu në studim potencohet avantazhi i aplikimit të një ambienti elektronik i bazuar në SharePoint. Në gjetjet e studimit janë identifikuar (ndarë) dy grupe të studentëve, grupi I dytë i studentëve implementuan projektin me veglat (tools) të gjedhura në mënyrë të pavaruar, të mbipërfaqësuar ishin shërbimet e office 365, grupi tjetër implementuan projektin në SharePoint, dhe si avantazh të përdorimit të sharePointit listuan “Teams site” në sharepoint ku kontenti, informacionet janë të postuara. Studentet krijuan resurse në SharePoint dhe shtuan edhe përdorues të tjerë, përdoruesit e tjerë u ftuan të marrin resurse dhe informata dhe ju kërkua atyre që të ndanin informata, dokumenta, lajme dhe resurse me pjesën tjetër të grupit. Mundësi e shtuar e SharePointit është kombinimi me “Yammer Contacts” dhe chatin e inkorporuar ndihmon në shpërndarjen e informatave përmbrnda grupit më shpejtë, përdoruesit e SharePointit mbrenda grupit të parë gjithashtu potencuan se shumë më lehtë mund të organizohen dhe komunojnë me antarë e po të njejtit grup në SharePoint, duke përfshirë edhe përdoruesit të cilët shfrytëzojnë telefonat celularë. [32]

Learning Management System në vete paraqet sfidë në vazhden e mësim dhënjes dhe mësim nxënjes. Implementimi i një sistemi për gjurmim të mësimdhënjes dhe informimit të studentëve në kohë, si dhe kontroll të detyrave të përditshme hulumtuese dha rezultat pozitiv në përmirësimin e metodave tradicionale të LMS-së. Integrimi i sistemit të mëparshëm në SharePoint shërbej si shtysë për përmirësim, dhe kontroll më të lehtë të procesit arsimor. Studimi i realizuar nga “Bruce Worobec”, dhe “Robert Brayant” në vitin 2016, në revistën “Journal of Computing Sciences in Colleges” autorët tentojnë të implementojnë SharePointin si “LMS”(Learning Management System), për shkak të mangësive të sistemit të tyre egzistues “Blackboard”, studimi mbulon arsyen se pse pikërisht SharePointi duhet implementuar në ambient universiteti, dhe gjithashtu mbulon edhe benifitet e SharePointit për dy vitet e ardhshme, si dhe sfidën që në SharePoint të ketë qasje cdo student. Pas një semestri duke përdorur “Blackboard LMS” stafi vendosi që të aplikojë SharePointin për shkak të aftësisë së SharePointit në menaxhimin e dokumentave. Në implementimin e sharepointit arkitektura e përdorur për implementim ishte si më poshtë:

- Pjesët e webit ( Web Parts)
  - Vocabulary List
  - Timeline Task List
  - Announcements
  - Links
  - Calendar
- Instructor Site
- Course Site
- Team Section Sites

Disa nga kritikrat që SharePointi ka është konfuziteti që krijon gjatë implementimit, gjë e cila pamundëson navigimin në faqet e SharePointit, dhe menyra e organizimit të të dhënave përbrenda sajtit. Në përfundimin e implementimit autorët e cilsojnë si të frytshëm implementimin e SharePointit si “LMS”. [5]

Ndërthurja e intelegjencës artificiale me shërbimet e Microsoftit është e rëndësisë së madhe sidomos kur portali SharePoint mer përmasa të gjëra, dhe të drejtat e privilegjet ndahen në disa ose më tepër adiminatorë, të mbrendshëm dhe të jashtëm. Me anë të intelegjencës artificiale mund të bëhet detektimi i përmbajtjeve jo të përshtatshme përmbrenda portalit, dhe në mënyrë automatike, të hiqet autorizimi për publikimin e të njejtave. Studimi i realizuar nga “Madhura Deshpande” dhe “Piyush Nikam” në revistën “International Journal for Research in Applied Science & Engineering” të botuar në vitin 2020 me titull “Artificial Intelligence in Microsoft SharePoint using Azure Cognitive Services” (“Intelegjenca artificiale duke përdorur shërbimet e njohjes së azurit”) autorët theksojnë së kërkimi i imazheve ose objekteve tjera vizuale gjithnjë e më tepër bëhet më i vështirë në SharePoint, sepsë kërkimi i imazheve gjithnjë e më tepër nuk bëhet me anë të emrit të imazhit me të cilin është ruajtur, gjithsecili me të drejtë kontribuimi në SharePoint mund të postojë imazhe jo të përshtatshme, gjë e cila duhet të filtrohet manualisht, dhe si rrjedhojë ka shpenzime dhe humbje në kohë. Për parandalimin e këtij problemi autorët sugjerojnë Intelegjencën Artificiale me ndihmën e “Azure Cognitive Services” që ngërthen “Computer Vision, Text Analysis, dhe Content Moderator” me MS Flows në SharePoint. Teknologjia e përdorur për aritjen e zgjidhjes në problemin e lartëpërmundur konsiston në tri hapa:

1) Microsoft SharePoint: Cdo imazh, apo video e cila postohet në librarinë e Microsoft SharePointit do të inicojë MS-flow

2) Pas aktivizimit të MS-flow, shërbimet e azurit nëpërmjet API do të thiren; si shembull: Computer Vision API, Text analytics APT, dhe Content Moderator API.

3) Azure Cognitive Services: API e lartëpërmendura përodren për analizimin e të dhënave të cilat ngarkohen (Uploaded) në platformën SharePoint, dhe kthen rekomandime për të njejtat, në analizën e tekstit, API analizon gjuhën, si dhe frazat e përdorura dhe a është i lejuar përdorimi i tyre, në analizën e imazhave analizon imazhin, dhe si përgjigje jep, a i plotëson imazhi kushtet për upload. Si përfundim autorët theksojnë mundësinë e aplikimit të intelegjencës artificiale në SharePoint, dhe efektet positive të tij. [24]

Në përpjekjet për dixhitalizim në Zelandën e Re, gjatë dhenjës së zgjidhjeve se si të rritet produktiviteti në kompanitë e vogla dhe të mesme, si platforme e zgjedhur për menaxhimin, u përcaktua Microsoft SharePointi. Mundësitë që ofronte SharePointi ishin më të përafërta me kërkesat e drejtuara nga udhëheqësitë e kompanive. Studimi i realizuar nga “Marco Polo de Jesus Cetina Abreu” dhe “Negateja Kothamasu” në vitin 2017 me titull “Capabilities of Microsoft SharePoint Online to boost New Zealand SMEs Productivity” (“Aftësitë e Sharepointit Online që të ris produktivitetin në kompanitë e vogla dhe të mesme në Zelandën e Re”) autorët analizojnë SharePointin Online dhe mundësitë e platformës për ritjen e produktivitetit në kompanitë e mesme dhe të vogla në Zelandën e Re. Autorët theksojnë se bashkpunimi në ambientin e punës është gati se i patjetërsueshëm në kompanitë e vogla dhe të mesme, gjithashtu potencojnë nevojën për përdorimin e “cloud computing” dhe “sharing files” në kohë reale, dhe shfrytëzimin e kanaleve të reja komunikimit në mes klientëve dhe punonjësve. Zgjidhja të cilën propozojnë autorët mundëson krijimin e një “Intraneti” ku të punuarit mund të ndajnë, kërkojnë, dhe menaxhojnë kontentin, dhe të bashkunojnë përmbrenda organizatës me të gjithë zinxhirin hierarkik në mënyrë të sigurt. Për implementimin e SharePoint Online autorët theksojnë se kompanitë kanë edhe levërdi ekonomike, pasi që është pjesë e “Microsoft 365”, si pjesë e aplikimit të SharePointit autorët propozojnë që kompanitë të përodrin komponentët e më poshtëm për realizimin e detyrave:

- Sites to Customise the Workplace ( Grup websajtesh që bëhen pjesë e një hapsire bashkpunuese, dhe çdo kush nga antarët mund të ndajë informata lirshëm, mund të shfrytëzohen si hapsira pune për departamente, projekte, apo edhe ekipe në çdo kompani)
- Lists ( Lista është një component websajti që shërben për futje, ndarje, dhe manaxhimin të informacionit, është një ndihmese e madhe, në qoftë se dëshirojnë krijimin e



databazave në menyrë të shpejtë shembull: Si Excel, por Online )

- Web Parts ( Një pjesë e sajtit, që ndihmon në ndërtimin e blloqeve të komponentëve të cilët paraqiten në platformë, me Web Parts nënkuptojmë të gjithë kontentin duke përfshirë imazhet, grafikonet, listat e dokumenteve, kodet e futura, hartat.
- Document Libraries ( Një hapsirë përbrenda sharepointit ku do të plasohen të gjithë dokumentet nga çdo departament dhe çdo projekt, një librari mund të përdoret për organizimin e dosjeve, që më e lehtë të jetë gjetja dhe qasja në to )
- Workflows( Një sekuençë ngjarjesh përbrenda intranetit, e cila në mënyrë automatike punët rutinore i kryen, gjë e cila rrit produktivitetin përbrenda organizatës)
- Views ( Përdoret për vizualizimin e listës, apo librarissë në forma të ndryshme, varësisht kërkesës së përdoruesit për të dhënat e kërkuara )
- User Permission ( Funksion i cili jep akses ne sajt ose e limiton atë, leja zakonisht jepet në nivele të ndryshme, në shkallë të ndryshme për përdorues të ndryshëm )
- Power Apps ( Përdoret për krijimin e aplikacioneve të sofistikuara të biznesit përbrenda SharePointit )

Në përfundim të studimit konstatohet se SharePointi e ka mundësuar zhvillimin e shpejtë dhe të lehtë të proceseve të biznesit në kompanitë e mesme dhe të vogla në Zelandën e Re, duke marrë parasysh menyrën e zgjidhjes së problemeve, dhe lehtësinë e ofruar SharePointi duket si zgjidhje ideale për bizneset, por gjithnjë ngelën në vendimarrjen e menaxhmetit për implementim. [25]


Integrimi i aplikacioneve Mash Up (të përziera ) në SharePoint rezultojë të ketë efekt pozitiv në menaxhimin. Integrimi i Web Shërbimeve në SharePoint për përdorim të jashtëm është në thjerzën e planeve për projektin e implementimit të SharePointit në institucion. Web Shërbimet të ndërthurura në SharePoint japin mundësi më tepër, në kombinimin e të dhënave nga disa burime të ndryshme. Studimi i botuar nga Vijay K. Naik në “IBM. T. J Watson Research Center” në vitin 2015 me titull “ A Framework for Business Mashup Applications” (Kornizë pune për aplikacionet e përziera të biznesit ) autori analizon rolin e aplikacioneve të webit që kombinojnë të dhëna të ndryshme nga interneti dhe i paraqesin në mënyrë të kapshme për përdoruesin, aplikacionet meshup mund të kombinojnë të dhëna të ndryshme ti bashkojnë ato në mënyrë që të japin informacion sa më të saktë për vendimmarje sa më të saktë, burimet e të dhënave mund të jenë statike, të ndryshme në mënyrë të ngadaltë, dinamike, ose me ritëm të lartë të ndryshueshmërisë. Aplikacionet Mashup japin një alternative për bizneset për kryerjen e analizës së tregut, menaxhimit të brendit, relatat me konsumatorët, parashikime, për vërjen në funksion të analizave të lartëpërmendura aplikacionet duhet të adresojnë çështje të sigurisë, besueshmërisë, dhe çështje të tjera në domenin e IT-së. Për zhvillimin e një aplikacioni mashup të biznesit, platforma për zhvillimin e aplikacionit duhet të ketë një prag të ulët për përdoruesit, në mënyrë që zhvilluesit me pak ose pa eksperiencë në programim të mund të zhvillojnë aplikacionin. Si kornizë pune(Framework) në mashup aplikacionet mund të meren template të gatshëm për relata me konsumatorin, për menaxhimin e brendit, si dhe për ndjekje të porosive. Templatet e këtij lloji mund të zgjerohen, nëpërmjet programimit, por duhet njohuri mbi API, dhe Web Serviset. Në analizën e bërë autorët analizojnë disa metoda të veglave për meshup aplikacione, dhe krahasojnë karakteristikat e tyre, autori gjithashtu analizon edhe shërbimet ne cloud. Si platformë mashup më të qëndrueshme, dhe më pak të kushteushme autori cilson Sharepointin, dhe të gjithë aplikacionet të cilët mund të inkorporohen në SharePoint, korniza e punës (Framework) të cilën analizon autori dhe çështjen e sigurisë, apo kohës për kryerjen e detyrave (Run-time), si dhe backup/recovery, ia adreson templatit, dhe tregon se janë të gatshme. [29]

Reagimet se si funksionon portali SharePoint, dhe cilët janë efektet pozitive pas një kohe të gjatë të përdorimit të tij, dhe se si i njëjti rrit aftësinë bashkpunuese, gjithashtu edhe teknikaliëte të ndryshme se si bëhet bartja e të dhënave nga Word, Excel në SharePoint janë në fokusin e studimit të më poshtëm të publikuar nga “Ralph Buchal” dhe “Emmanuel Songsore” në vitin 2018 në revistën “Canadian Engineering Education Association” me titull “Collaborative Knowledge Building in SharePoint” ( “Bashkpunimi për informacion në SharePoint”) autorët theksojnë se qasja bashkpunuese në mësim, në kritikën konstruktive, në punën në grup, janë të pranuar si metoda pune efektive nga shumë kërkues shkencorë, student dhe staf i institucioneve arsimore. Gjatë analizës janë testuar dhe intervistuar kërkues shkencorë, student në opinionet e tyre në lidhje me platformat bashkpunuese, ku në focus të veçant ishte sharepointi. Në pyetjet se cilat ishin eksperiencat e studentëve në përdorimin e SharePointit, studiuesit u munduan të prekin çështje që ishin problematike në përdorimin e SharePointit nga studentët, duke ju kërkuar studentëve të listonin avantazhet, dhe disavantazhet e sharepointit. Në shumicën e përgjigjeve nga studentët si avantazh më i madh ishte aftësia bashkpunuese dhe ndjekja e ndryshimit të dokumentave të postuar në sharepoint. Gjithashtu studentët theksuan se ndjekja e ndryshimeve në dokument rrit përgjegjësinë, sepse kontributi i gjithsecilit është i dukshëm, gjithashtu ata theksuan se një ndër benifitet më të mëdha ishte edhe mundësia që SharePointi ofron për ndjekjen e punës nga mentori, si avantazh tjetër madhor u përmend edhe mundësia që të punojnë “offline” dhe mundësia që të punojnë në “Microsoft Word” në “Desktop” dhe në “Microsoft Word” në “Web Browsers”. Një pjesë treguan edhe eksperiencën jo aq të mire në përdorimin e e-mailit për projekte grupore, pasi që ne e-mail është e vështirë të gjindjen versionet e rreja, dhe të vjetra të dokumentit, e-mailin e cilësojnë si jo të mjaftueshëm për bashkpunim. Meqë studime ishte i fokusuar në pikpamjet e studentëve për SharePointin, autorët gjithashtu ishin të interesuar edhe për dinamikën e bashkpunimit dhe mënyrën se si bashkunohej. Për të aritur në rezultate sa më të sakta, dhe për të kuptuar në thelb metodën e bashkpunimit në SharePoint, subjektet u ndanë në dy grupe, dhe disa kushte bazë u vendosën në të gjithë subjektet, ku si kushte u vendosën “Aftësia në shkrim”, “Aftësia në inxhinjeri”, “Barazia, ku çdo antar do të bëjë sasi pune të njëjtë, bazuar në orarin vetanak të subjektit”, “Eksperienca e punës në inxhinjeri”, si dhe “Niveli i konfortit në aspekte të ndryshme të

projektit”, kushtet u vendosën në mënyrë që jo të gjithë të punonin në të gjitha fazat e projektit. Në përgjigjet dhe përshtypjet e studentëve, shumica e studentëve pohoj se bashkpunimi nën autoritetin e SharePointit, ndihmon në vendimarrje, punën me konkluzatë qarta, bashkimin e punës në mënyrë të qartë, organizimin e projektit. [35]

Në librin “ Beginning SharePoint Communication Sites – Creating and Managing Professional Collaborative Experiences” (“Hyrje në komunikimin e sajteve të SharePointit – Krijimi dhe menaxhimi profesional i hapsirave bashkpunuese” ) të botuar nga “Charles David Waghmare” në vitin 2019, autori bën përshkrimin e SharePointit në përgjithsi si platformë bashkpunuese, por theksin e vë në sajtet e komunikimit përbrenda SharePointit, tërësine e sajteve përbrenda platformës së SharePointit e quajtur “Hub-Sites” dhe shembujt e mer përbrenda departamentit të IT-së në organizatë, ai vë në dukje se komunikimi përbrenda organizatës është pothuajse i domosdoshëm, sidomos përgjatë kampanjave përbrenda kompanive ose organizatave, për komunikim të sukseshëm përbrenda departamenteve, duhet të krijohen, sajte komunikimi të cilat paraqesin “Templates të personalizuar”, të cilat e bëjnë procesin e punës më lehtë të menaxhueshëm, dhe përçojnë mesazhin nga njëri departament në tjetrin në kohë shumë të shkurtë, sajtet e komunikimit janë të aksesueshme nga pajisje të ndryshme, përdoruesit mund të konsumojnë informacionin, është e lehtë të kesh akses, të kontribuosh, dhe të krijosh kontent nga çdo pajisje. Në kapitullin e dytë të librit “Effectively Communicate and Collaborate Using Communication Sites” autori shpjegon dallimin në mes sajteve të komunikimit dhe bashkpunimit, si shembull ai mer departamentin e “HR”(“Human Resources – Burimet Njerzore” dhe potencon disa nga çështjet që përballet ky lloj departamenti në shkallë botërore, si çështje që duhen adresuar janë” Mënyra e komunikimit nga lartë-poshtë në kuptimin hierarkik”, “Fokus jo i duhur i punonjësve”, “Komunikim në minutën e fundit”, “Dhe krijimi i një sistemi konkurrues të komunikimit”. Në kapitullin tre, “Build Collaborative Experiences for End Users”, autori përshkruan platformën e komunikimit “Yammer” që integrohet në sharepoint, ku potencon dobritë dhe avantazhet e “Yammerit” në krahasim me “E-mailin tradicional, ai thekson se “Yammer” ka avantazhe ndaj e-mailit përshkak të zbulueshmërisë më të madhe, nuk duhet të gjurmohet në inboks për të gjetur informacionin e kërkuar, është më i shpejtë, është i paafektur

nga spami, kontrollohet në mënyrë më të lehtë, dhe sugjeron integrimin e “yammerit në SharePoint”. Në kapitullin e katërt “Create Digital Intranets”, ku përshkruan Intranetin, ai thekson se Intraneti është e kundërta e Internetit, autori thekson se intraneti është rrjet privat i përdorur nga organizata për të komunikuar me përdoruesit ku të njëjtën e shpjegon me anë të diagramit të më poshtëm



*Figure 1- Framework for a digital Intranet Using Communication Sites*

Në pjesën e përdorimit të “Webparts” në sajtet e komunikimit të SharePointit, autori liston disa nga pjesët e webit të cilin mund të inkorporohen në SharePoint, të cilat i liston si më poshtë Topic(Hero,News,Events,Highlighted Content), Showcase(Hero,Image Gallery), Blank(Bing maps, Connectors, Divider, Document Library), Embed, File Viewer, Group Calendar, Kindle Instant Preview, Link, Powerapps. [43]

Në librin “Custom SharePoint solutions with HTML and Javascript for SharePoint 2013, and SharePoint Online” të botuar nga “Brandon Atkison”, autori jep zgjidhje për çështje të ndryshme duke shfrytëzuar “HTML” dhe “Javascriptin” në kapitullin e parë, shpjegon ambientin e zhvilluesit, dhe softet që duhen instaluar për implementimin e zgjidhjeve, dhe jep një

shpjegim të shkurt të teknologjive të përdorura, më pas vazhdon me implementimin e “jQuery” në pjesën “Front-End” të SharePointit dhe si duhet bërë instalimi i “jQuery” dhe si të publikohen faqet e zhvilluara, në pjesën e dytë shpjegon mënyrën e zhvillimit në pjesën e pasme (“Back-end”) të SharePointit dhe shpjegon për komponentët e front-endit ku theks të veçant ka në “JavaScript Object Model (JSOM)”, “REST API”, “JS Link”, dhe “Display templates”. Në kapitullin e tretë shpjegohet pjesa e “Content Editor dhe Script Editor në Web-Parts”, ku hap pas hapi shpjegohet se si duhet të bëhet ndryshimi në komponentë të “Web-Parts” dhe si bëhet lidhja e tyre me dokumentet “HTML” si shembull merë inkuorimin e nje “Div” elementi në SharePoint dhe mënyra e implementimit është e njejtë si në “Visual Studio” “<div id=“divHelloWorld”> Hello World!</div>”, në editorin e skriptave e shpjegon të njejtën ku implementimi i kodit në “Javascript” bëhet nëpërmjet jQuery dhe kodi i implementuar në pjesën e komponentëve të webit është

```
“ “ <script type=“text/javascript”>
$(function(){
  alert(“Hello World!”);
});
</script>”
```

Kodi i më sipërm është kod testues, për të testuar integrimin e javascriptit në “Web Parts” përbrenda SharePointit. Në kapitullin e katërt, autori shpjegon metodën e Ethersanit për inkuorimin e “Web-Parts” në SharePoint, ai thekson se gjatë procesit të punës, zgjidhja e kolegut të tij ishte të zhvillonte web shërbime të kostimuzara (“WCF- Web Communication Framework”) të cilat mund të thireshin nëpërmjet Javascriptit, të njejtat shërbime plasoheshin në server së bashku me kodin HTML dhe Javascript të inkuoruar në to. Metoda e “Ethersanit” përbëhet nga kompoentët e më poshtëm

- Document Library ( Libraria e dokumente )
- Folders ( Skedarët )
- Content Editor Web Parts

- HTML, JavaScript, and CSS

Fuqia e këtij kombinimi qëndron në faktin se thjeshtësinë dhe fuqinë e Javascript Object Model dhe REST API, në egzaminimin e çdo njërit nga komponentët e mësipërm autori shpjegon hap pas hapi se si implementohet metoda e lartpërmendur në SharePoint dhe benefitet të cilat i sjell përodrimi i kësaj metode në zgjidhjen e problemeve. Në kapitullin e gjashtë “Content Search Web Part and Display Templates “ shpjegohet mënyra e kostumizuar e kërkimit, shtimit, dhe fshirjes së dokumenteve përbrenda SharePointit, si dhe dhënjen dhe largimin e privilegjeve për përodruesit. [3]

Në librin “Understanding Hybrid Environments in SharePoint 2019 Building and Implementing Features” të botuar në vitin 2019 nga “Nanddeep Sadanand Nachan” dhe “ Smita Sadanand Nachen” analizohet dhe jipet zgjidhje për ambiente Hibride në SharePoint 2019”. Në kapitullin e parë të librit flitet për mënyrën e instalimit të SharePoint serverit, dhe ambientit zhvillues dhe shpjegohet nevoja për ambientin hibrid në cloud, ku si avantazhe përmenden kontrolli, siguria, gjithëpërfshirja (scalability) , si dhe integrimi i platformave tjera. Për implementim të ambientit hibrid duhen SharePointi, Lisenca e office 365, qasje ne Azzure, dhe kanale të sigurta komunikimi. Në kapitullin e gjashtë “Configuring the Home Page in SharePoint server” ka manual hap pas hapi se si realizohet konfigurimi dhe shpjegon funksionalitete të ndryshme që duhet krijuar dhe konfiguruar, si funksione që duhet krijuar dhe konfiguruar janë:

1. Managed Metadata Service application
2. Search Service application
3. Enterprise Search Center site
4. My site Host site
5. User Profile Service application
6. Import profiles from Active Directory (Optional)

## 7. Distributed cache (optional )

Faqa e sharepointit do të duket ndryshe në çdo user bazuar në aktivitet e tyre dhe faqet që i ndjek. Cdo përdorues do të ketë profil në “User Profile Service application”, ndërsa funksioni i “Search Service application” duhet të konfigurohet në mënyrë që të nxjerr informacion nga çdo sajt. Në kapitullin e dymbëdhjetë të librit flitet për konfigurimin e taksonomisë hibride në SharePoint 2019, dhe theksi vendoset në sinkronizimin e të dhënave nga “cloudi” në pajisjet lokale. Taksonomia hibride e sharepointit ndihmon në mirëmbajtjen e taksonomisë (klasifikimit) të vetëm në SharePoint server dhe SharePoint online. Zhvilluesi i platformës mund të zgjedhë që klasifikimi grupor (taksonomia) të jetë e shpërndarë në SharePoint server dhe SharePoint online, zakonisht klasifikimi i ndarë vendoset në SharePoint online, ndërsa një kopje “read-only” mbahet në SharePoint server. Në ruajtjen dhe marjen e të dhënave autori potencon se jo në çdo skenar duhet një zgjidhje, ai potencon se në qoftë se burimi i të dhënave është në “Azure SQL DB” nuk duhet një “Gateway” apo zgjidhje, në qoftë se burimi nga ku meren të dhënat në SharePoint është databazë lokale SQL, duhet një zgjidhje për burimin, dhe kanalizimin e të dhënave, dhe shpjegon mënyrën se si të arihet deri kanalizimi dhe zgjidhja e burimit të të dhënave. Në pjesën e “Power BI integration with SharePoint Server 2019” tregon se si mund të integrohet “Power BI” dhe benefitet e “PowerBI”, shpjegon arkitekturën e integritit në SharePoint server, në qoftë se shërbimi është në “Azure” automatikisht një “Azure Service buss” konfigurohet për “Power BI”. Në pjesën tjetër flitet edhe për integrimin e Power Apps në SharePoint Server, Power Apps konsiston në dy lloje: Canvas Apps, dhe Model-driven apps. Canvas apps japin fleksibilitet që përdoruesi të mund të konfigurojë aplikacionin sipas dëshirës apo, një burimi vetanë të të dhënave. Model driven apps mund të zhvillojë në mënyrë shumë të shpejtë forma, regulla biznesi, procese, duke përdorur një shërbim të dhënash të përbashkët, në kapitujt në vijim tregohet mënyra se si realizohet ndërtimi i Power Apps në mënyrë vizuale. Në kapitullin e fundit shpjegohet “Power Automate Integration” nëpërmjet “Microsoft Flow”, automatizimi i tasqeve rutinore përbrenda kompanisë apo organizitës, si përshembull dërgimi i e-mailve rutinore, apo kontrolli i përditësimeve të rreja. [28]



Në librin “Beginning Powershell for SharePoint 2016 – A Guide for Administrators, Developers, and DevOps Engineers” të botuar nga “Nikolas Charlebois – Laparde” dhe “John Edward Naguib” të botuar në vitin 2016, autorët ofrojnë zgjidhje për shumë sfida, që në verisonet e mëhershme të SharePointit, kanë qenë te realizusheme me vështirsi, të gjitha nëpërmjet “PowerShellit”. Në kapitullin e dytë të librit tregohet se si mund të realizohet “Fast Site Creation” nëpërmjet Powershellit dhe avantazhet e administrimit të SharePointit nëpërmjet PowerShellit, ku si avantazh liston “Zero Downtime Patchin” funksion i cili përditson version e SharePoint serverit në kohë të shkurtër, “OneDrive Redirection” mundëson bartjen e “Mysite” në “Office 365” . Në funksionin “Fast Site Creation” në “PowerShell” mundësohet krijimi i një koleksioni të rri faqesh me një resht kodi si më poshtë:

```
“New-SPSite http://localhost/sites/FC1 -Template “STS#0” -ContentDatabase“WSS_Content” -  
OwnerAlias “Contoso\<user account>” -CreateFromSiteMaste”
```

Në kapitullin e tretë shpjegohen komandat bazike të “Powershellit të përdorura në SharePoint”, shpjegohet për punën e sesioneve të “PowerShellit”, për kostumizimin e komandave në “PowerShell”, dhe diferenën në mes “Powershell Snap-Ins” dhe “Powershell Modules”, ku në përshkrimin e “PowerShell Snaps-Ins” shpjegohet se janë një grup metodash dhe objektesh që mund të importohen në sesion ( Ngjajshëm me “namespaces” që importohen në fillim të klasave “), në përodrimin e “PowerShellit” shpjegohet edhe përodrimi i variablave ku shpjegohet se varibalt në “PowerShell” deklarohen dhe referencohen me operatorin “\$” si më poshtë:

```
“$myVariableText = “My favorite number is:  
$MyVariable Number = 7  
Write-Host $myVariable $myVariableNumber “
```

Në pjesën e “Casting” process i cili konverton objektin nga një lloj në tjetrin, autori potencon se mënyra e realizimit të këtij operacioni bëhet nëpërmjet kllapave të mëdha “[()]” duke ia shtuar objektin që duhet konvertuar si më poshtë:

```
"$stringValue  
Write-Host ([int] $stringValue + 13)  
Write-Host $stringValue +13"
```

Si pjesë më të rëndësishme autori potencon "Domain Controller" ku për konfigurim të "Domain controllerit" jep skriptën e më poshtme që duhet ekzekutuar: "

```
"$domainName = "contoso.com"  
$safeModeAdminPassword = ConvertTo-SecureString "pass@word1" -AsPlainText -Force  
Add-WindowsFeature AD-Domain-Services -IncludeManagementTools  
Install-ADDSForest -DomainName $domainName -  
SafeModeAdministratorPassword$safeModeAdminPassword -Confirm:$false"
```

Ekzekutimi i kodit të mësipërm do të deklaroj një domain të ri të quajtur "Contoso.com" në "SharePoint" dhe automatikisht do ta promovojë atë. Në pjesën e administrimit të përdoruesve dhe grupeve në SharePoint nëpërmjet Powershellit autori jep metodën e më poshtme për shtrim të grupeve dhe përdoruesve

```
"New-ADGroup -DisplayName "Administration" -GroupScope DomainLocal -Name  
"Administration"  
New-ADGroup -DisplayName "Finance" -GroupScope DomainLocal -Name "Finance"  
New-ADGroup -DisplayName "Human Resources" -GroupScope DomainLocal -Name "Human  
Resources"  
New-ADGroup -DisplayName "Directors" -GroupScope DomainLocal -Name "Directors"  
New-ADGroup -DisplayName "Tech Support" -GroupScope DomainLocal -Name "Tech Support"
```

Më pas në krijimin e përdoruesve që do jenë pjesë e grupeve ekzekuton linjën e kodit si më poshtë për krijimin e profilit

```
" $usersPassword = ConvertTo-SecureString "pass@word1" -AsPlainText -Force  
New-ADUser -Name "JSmith" -GivenName "John" -Surname "Smith" -AccountPassword  
$usersPassword -UserPrincipalName "jsmith@contoso.com" -DisplayName "John Smith"
```

```
Enable-ADAccount -Identity "JSmith"
Add-ADGroupMember -Identity "Administration" -Member "JSmith" "
```

Kodi i më sipërm krijon profil për një përdorues dhe i vendos passwordin "pass@word1", i njejtë kod përsëritet për krijimin e profileve të tjera. Në kapitullin e katërt autori shpjegon mënyrën e instalimit të SharePointit dhe SQL Serverit nëpërmjet PowerShellit, dhe krijimin e databazës, e cila do të jetë në funksion të SharePointit, me anë të reshtave të më poshtëm të kodit të ekzekutuara në "PowerShell"

```
"$spConfigDBName = "SPConfig" # Config DB name, replace by your own;
$spAdminDBName = "SPAdmin" # Admin DB name, replace by your own;
$spPassphrase = "pass@word1" # Recommendation is to change this to something else;
$spFarmAdminPassword = "pass@word1" # replace by your admin account password;"
```

Në konfigurimin e administrimit qëndror autori supozon se "Central Administration Site" duhet të plasohet në një port jo standard që është më i lartë se 999, në linjat e më poshtme të kodit përdoret porti 7777, dhe kodi ekzekutohet si më poshtë:

```
"$centralAdminPort = 7777
New-SPCentralAdministration -Port $centralAdminPort -WindowsAuthProvider "NTLM"
```

Ndërsa në krijimin e "SharePoint Web Aplikacionit" bëhet duke ekzekutuar "New-SPWebApplication" funksion i cili kërkon të specifikohet emri i web aplikacionit. [31]

Në librin "Creating Business Applications with Office 365 – Techniques in SharePoint, PowersApps, PowerBI and More " me autorë "Jeffery M.Rhodes" te botuar në 2019 autori jep zgjidhje për "SharePointin" dhe aplikacionet tjera të "Office 365" të kombinuara me "HTML", "Jquery", "CSS", "JSON," në kapitullin e parë potencon se shumë nga zgjidhjet e SharePointit implementohen ose nëpërmjet SharePoint Designer, ose duke futur kodin e krijuar në

“Javascript”, “HTML”, dhe “CSS” direkt në SharePoint. Në kapitullin e tetëmbëdhjetë të librit bisedohet për inkorporimin e një faqeje SharePoint në një sajt publik, për këtë lloj problematike autori sugjeron që të përdorim “embedded code” dhe të ndërtojmë “iFramin” personal. Meqë duhet përdorur “Content Editori” për ta mundësuar “iFrame” tekst dokumentin duhet të shtohet një faqe klasike me anë të kodit të mëposhtëm:

```
<div id="boardParent">  
<iframe id="boardFrame"  
src="https://plattecanyon.sharepoint.com/samples/Lists/EventsCalendar/ColorCalendar.aspx"  
scrolling="no"></iframe>  
</div>
```

Më pas me anë të të CSS stilizohet “iFrame” i krijuar, dhe i njëjti me atë të “embedded code” të gjeneruar automatikisht mund të bartet në sajt public

Në kapitullin e njëzet “Using SharePoint REST Services to Control E-mail Settings” autori tregon se si me anë të “InfoPath” dhe shërbimeve REST (REpresentational State Transfer) të lexohet lista e përdoruesve që duhet të ju dërgohet e-mail. Në kapitullin njëzet e një “Creating a Class Sign-Up solution in SharePoint: InfoPath” shpjegohet hap pas hapi krijimi i një forme për “Sign-Up” në “SharePoint” duke përdorur “InfoPath” dhe e njëjta ti koleksionojë të dhënat në mënyrë automatike pas regjistrimit “Sign Up”. Në kapitullin e njëzet e tre, bëhet fjalë për inkorporimin e “Google Analytics” në “SharePoint” për mbledhjen e të dhënave për përdoruesit, edhe pse platforma në “SharePoint” nuk është e dedikuar për përdorim të jashtëm, gjithsesi një pasqyrë analitike është e nevojshme, autori shpjegon se përfshierja e “Google Analytics” duhet të bëhet për klikimet individuale të çdo njërit nga përdoruesit, dhe për këtë përdor “Google Tag Manager” të cilën e inkorporon në “SharePoint” me anë të kodit të dhënë nga “Google Tag Manager” në “Content Editor”. [21]

## Qeverisja dixhitale dhe strategjia e implementimit të SharePoint portalit

Qeverisja dixhitale nënkupton ofrimin e shërbimeve të ndryshme të teknologjisë informative në sektorin publik, ndarjen e informacionit, integrimin e shërbimeve në mes qeverisë dhe qytetarëve(G2C- “Government to go citizen”),qeverisë dhe biznesit(G2B”Government-to-business”), qeverisë dhe punonjësve(G2E”Government-to-empolyees”), si dhe gjithë proceseve dhe shërbimeve në të cilat përfshihet një institucion publik në raport me qytetarët[14]. Nëpërmjet “E-governance” synohet që proceset të jenë transparente, të kapshme, dhe efikase.

Në implementimin e një sistemi qeverisës dixhital në rastin e institucionit publik ku zgjidhja propozohet, kemi të bëjmë me një shumësi departamentesh, dhe numër të madh punonjësish. Me modelin e propozuar synohet që të përfshihet korniza e punës së institucionit në të gjithë sferat e veprimtarisë së tij. Platofrma menaxhuese për qeverisje dixhitale është propozuar të jetë “SharePointin” ngaqë përfshinë tri elemente kyçe në realizimin e punës [49]

- Politikat e insitucionit
- Rolet në institucion
- Proceset në institucion

Meqë zbatimi i elementeve të mësipërme është i rëndësisë primare për funksionim të insitucionit, në zgjidhjen e propozuar do të përfshihen tri segmentet e lartëpërmendura për funksionim sa më efiksat të portalit “SharePoint”. Zgjidhja e propozuar do të jetë nëpërmejt “intranetit” ose rrjetit të brendshëm të organizuar në përputhshmëri me hiarkinë e institucionit dhe kulturën e punës përmbranda institucionit. Zgjidhja e më poshtme shpjegon planifikimin e intranetit përmbranda institucionit[50]




Figure 2/ Model qeverisës në "SharePoint" propozuar nga "Microsoft"

## Vizioni

Me implementimin e intranetit në "SharePoint" përmbynda institucionit synohet lehtësim në bashkpunim, dhe qeverisje efektive e departamenteve, gjithnjë në kuadër të politikave institucionale në të cilat zhvillohet procesi punës. Nëpërmjet një definimi të qartë të visionit synohet të planifikohet mënyra e qeverisjes në "SharePoint", gjithashtu në bazë të strukturës organizative dhe informacioneve që ndahen në mes departamenteve do të definohet qartë procesi i punës dhe bashkpunimit në mes departamenteve të ndyshme. Definimi i një visioni të qartë ndihmon në procesin e implementimit, duke ju dhënë përgjigje pyetjeve "se çka synohet pas implementimit" dhe "cilët janë benifitet dhe përparsitë e implementimit". Më poshtë të listuara janë pikat kyçe në të cilat është mbështetur visioni i qeverisjes nëpërmjet "SharePointit".

- Synohet thjeshtëzim i procesit të punës; Me implementimin e intranetit në SharePoint synohet thjeshtëzim i procesit të punës dhe automatizim i proceseve rutinore përmbynda institucionit. Meqë SharePointi si platformë përdoret kryesisht në ambiente dinamike të biznesve, i njejtj jep zgjidhje të shpejta dhe të besueshme për procese të

ndryshme. Definim i qartë i roleve dhe përgjegjësisë në mes të punonjëve, shmang komplikimet në ndarjet dhe marjet e përgjegjësisë, punonjësit do kenë regulla dhe përgjegjësi të qarta në platformën e SharePointit.

- Synohet strukturim i departamenteve dhe politikë rigoroze në përdorim, meqë qasja në SharePoint do jetë e dyanshme(stafi administrative, akademik, dhe studentët), strukturimi i qartë i departamenteve dhe përgjegjësitë që iu alokohen departamenteve përkatëse duhet të jetë rigoroz dhe i qartë. Qasja e më vonshme nga ana e studentëve në portal, gjithashtu duhet të ketë regulla strikte në politikat e përdorimit, dhe ngarkimit (Upload) të dokumenteve në SharePoint.
- Synohet bashkpunim i frytshëm në mes departamenteve dhe përditsim i qartë i dokumenteve, meqë institucioni është me numër të lartë punonjësish dhe studentësh, qarkullimi i dokumenteve është i lartë, shpesh herëë dokumenti i njejtë i përditsuar ose plotësuar është e vështirë të gjindet në versionin e fundit të tij, me implemtimin e “SharePointit” synohet të zgjidhet kjo lloj problematike. Gjithashtu në qoftë se dokumenti duhet të qarkullojë në disa departamente kërkohet bashkpunim dhe llogaridhënje në mes departamenteve, zgjidhja në SharePoint do të ofrojë këtë mundësi duke iu dhënë departamenteve të ndryshme kompetenca dhe përgjegjisi adekuate në menaxhimin e faqeve të tyre komunikuese në SharePoint.
- Synohet dixhitalizim i procesve dhe vendimmarjes përmbrnda institucionit, në raste kur komunikimi përmbrnda institucionit mungon për arsye të ndryshme, dhe vendimmarja vonohet për shkak të komunikimit, implementimi i SharePointit do të thjeshtëzojë procesin duke qartëzuar detyrat e departamenteve dhe punonjëve, gjithashtu për shkak të dinamikës së punës ndarja e informacionit në SharePoint do të ndihmojë në dixhitalizimin e procesve, marja e informatës nga pala e tretë do të jetë më e lehtë, pasi do ketë qasje direkte në informacionin ose dokumentin e duhur.

- Synohet centralizim dhe qasje në të dhëna, aspekti tjetër i rëndësishëm është qasja në kohë reale në të dhëna, dhe një “databazë” e të dhënave, ku qasja do jetë në mënyrë hierarike në bazë të organogramit.

## Modeli propozuar i qeverisjes dixhitale përmbrnda institucionit

Modeli propozuar më poshtë sintetizon tri elementet kyçe në procesin e punës së institucionit, politikat e institucionit, rolet në institucion dhe proceset e punës në institucion, gjatë implementimit të SharePointit është e domosdoshme përfshirja e elementeve të lartpërmendur, andaj modeli i propozuar për qeverisje dixhitale do të konsistojë në modelin e propozuar më poshtë:




Figure 3 Modeli i propozuar i qeverisjes dixhitale në rastin e institucionit publik



- Roli i departamenteve – Për çdo departament do të krijohet nga një faqe në intranet në formën e SharePoint Hub, e cila do mundësojë funksionimin e të gjitha faqeve të departamentit nën një ombrellë(Hub), ku do mund në kohë reale të postohen të gjitha çështjet lidhur me departamentin nga udhëheqësi i departamentit, roli i departamenteve gjithashtu është parësor në procesin e funksionit të intranetit, pasi që e gjithë veprimtaria dhe procesi punës mvaret nga departamentet
- Rolet individuale – Në intranet qasje do ketë çdo punonjës, çdo njëri nga to, do të ketë roletin dhe politikën përdoruese të definuar qartë, në mënyrë të vazhdueshme do inkurajohet përdorimi i shërbimeve të SharePointit në procesin e punës, rolet individuale do mvaren nga lloji i departamentit dhe pozitës së punës.
- Qeverisje dixhitale – Impementimi i SharePointit bëhet në mënyrë që të të menaxhohet në mënyrë më transparente, dhe të lehtë procesi i punës, qeverisja dixhitale nënkupton elementet e lartëpërmendur dhe synon transparencë të plotë, dhe përgjegjësi individuale.
- Përditsim i SharePointit në baza ditore për çdo departament – Faqet e komunikimit, ose të ekipeve duhet të përditsohen në baza ditore për efektshmëri më të lartë, dhe kontroll më të detajuar të procesit të punës, sidomos në proceset e punës manuale(Shembull: Plotësim i dokumentave me dorë )
- Përditsim i informatave në SharePoint – Në faqen komunikuese ose ( Landing Page ), duhet të përditsohen informatat dhe kalendari në baza ditore, për qartësi dhe ndarje të përgjegjësive në mënyrë sa më të lehtë.
- Komunikim i vazhdueshëm përbrenda SharePointit – në implementimin e SharePointit do të inkuadrohet edhe platforma “Yammer” e cila mundëson komunikimin përbrenda intranetit, në mënyrë joformale, dhe postimi ose (“Uploadi”) në SharePoint i informatacionit të kërkuar.

- Role, përgjegjësi dhe privilegje të definuara qartë për çdo përdorues – Secili përdorues do ketë të definuar qartë përgjegjësitë, rolin, dhe privilegjet. Departamenti I IT-së përbrenda institucionit do të jetë administratori kryesorë, por çdokush nga punonjësitë do ketë manualin e përgjegjësi dhe privilegjeve për rolin e tij në intranet.
- Qasje për çdo punonjës në SharePoint – çdo i punësuar në administratë, ose stafi edukativ do të kenë qasje në SharePoint, në këtë mënyrë edhe bashkpunimi bëhet më i lehtë, dhe efektiv.
- Procesim i kërkesave të drejtuara nga çdo departament – Në rastin e kërkesës së drejtuar nga një departament në tjetrin, do jetë e preferueshme që kërkesa, apo dokumenti, të ngarkohet(upload) sërish në sharepoint, dhe i njëjti do ketë “Track progress raport” për të ndihmuar në realizimin e kërkesës dhe njoftimin e përdoruesve, se ku ka aritur procesimi i kërkesës së tyre.
- Përmirësim i vazhdueshëm i shërbimeve – Tentohet përmirësim i vazhdueshëm i gjitha shërbimeve përbrenda institucionit nëpërmjet SharePointit, dhe automatizim i procesit punues, gjithashtu synohet edhe integrim i shërbimeve tjera përbrenda SharePointit.
- Procese të automatizuara - konsiderohen të gjitha proceset të cilat janë të zbatuara në mënyrë automatike (Overview of workflows included with SharePoint, n.d.) , dhe në të cilat nuk ka intervenim nga jashtë, në rastin e implementimit në institucionin ku implementohet SharePointi, nuk kemi ende strategji të hartuar për zbatimin e proceseve të automatizuara.
- Procese gjysëm të automatizuara – proceset të cilat janë të udhëhequra nga “PowerShell” ose ndonjë aplikacion tjetër “Third-Party” i inkuadruar ne SharePoint, proceset gjysëm të automatizuara sigurojnë menaxhimin e SharePointit, politikave përdoruese, dhënjën e

lejeve, privilegjeve, nga që me një komandë mund të zbatohet urdhëri në të gjithë intranetin, shembull në process të gjzëm automatizuar është shtrimi i adiministratorit në SharePoint i egzkektuar në PowerShell [17]:

*“Add-SPOGeoAdministrator -UserPrincipalName [Tk@TulantK.onmicrosoft.com](mailto:Tk@TulantK.onmicrosoft.com)”*

- Proceset manual – konsiderohen të gjitha proceset ku ka intervenim manual në SharePoint, process i cili është konsumues në aspektin kohorë në rastin e institucionit ku bëhet implementimit të SharePointit.

## Arkitektura e intranetit dhe Hub faqet

Faqet Hub në SharePoint janë blloqe faqesh komunikuese që ndërlidhin shumësi faqesh në intranet të organizuara si faqe që koleksionojnë “nën faqet” tjera të po ati departamenti, janë nyja lidhëse e departamentit me faqet komunikuese dhe faqet e ekipeve. Nga principet moderne të intraneve modern është krijimi i Hub-Faqeve për çdo njërin nga departamentet, gjë e cila ndihmon në menaxhimin më të lehtë të intranetit, dhe rritjes eventuale. Secila nga Hub faqet ka privilegjet e saja dhe kontrollon disa nga “nen-faqet” e saja. [18].

Dhënja e privilegjeve realizohet nëpërmjet PowerShellit me anë të skriptës së mëposhtme:

*“Grant-SPOHubSiteRights <https://taulantk.sharepoint.com/sites/rektoratiHub>*

*-Principals [taulant@TulantK.onmicrosoft.com](mailto:taulant@TulantK.onmicrosoft.com)*

*-Rights Join”*

Ndërsa në pjesën e kostumizimit të temës(Theme) të përdorur është zbatuar kodi i më poshtëm në JSON për zbatimin e temës dhe krijimin e një liste për nevojat e institucionit:

```
{  
  
  "$schema": "https://developer.microsoft.com/json-schemas/sp/site-design-script-  
actions.schema.json",  
  
  "actions": [  
  
    {  
  
      "verb": "applyTheme",  
  
      "themeName": "Contoso Explorers"  
  
    },  
  
    {  
  
      "verb": "createSPList",  
  
      "listName": "Customer Tracking",  
  
      "templateType": 100,  
  
      "subactions": [  
  
        {  
  
          "verb": "setDescription",  
  
          "description": "List of Employees"  
  
        },  
  
        {  
  
          "verb": "addSPField",  
  
          "fieldType": "Text",
```

```

"displayName": "Employee Name",


"isRequired": false,

"addToDefaultView": true

},

```

I njehti kod përsëritet për kolumna të tjera, në varësi të nevojave [2]  
 Krijimi i Hubave bëhet në mënyrë manuale dhe arkitektura e intranetit e bazuar në Hube është si  
 mëposhtë:




*Figure 4/ Arkitektura e intranetit e bazuar në Hub (Rektorati/Hub)*

Krijimi i hubit luan rol të rëndësishëm në strukturimin e intranetit, me fjalë tjera është faqe e krijuar për të ndërlidhur faqet nën një ombrellë, komunikimin e njoftimeve të rëndësishme, dhe platformë bashkpunuese. Implementimi i Hube-ve mundëson njohje me vendimet e reja përmbrnda institucionit, lajmet e fundit, dhe detyrat e secilit nga departamentet përmbrnda institucionit. Në rastin e institucionit Hubi i implementuar ndërlidhë departamentet si më poshtë:

- Peace/ut
- Career/ut
- Diplomat/ut
- It/ut
- ScienceandInnovation/ut
- Education/ut
- Phd/ut
- Projects/ut
- Evalution/ut
- Finance/ut
- Legal/ut
- Languages/ut

Në departamentet e më sipërme egzistojnë edhe nën ndarje të faqeve të krijuara, të cilat si urë lidhëse me Hubin e përgjithshem kanë faqen e tyre bazë. Gjatë krijimit të Hubit janë marrë parasysh eksperiencat e përdoruesve, dhe kulturën e punës në institucion. Në pjesën organizative dhe planifikimit të Hubit janë marë parasysh dy koncepte asociimi dhe navigimi. Gjatë procesit të asociimit është marrë parasysh dhënja e lejeve dhe privilegjeve udhëheqësve të departamenteve, si dhe departamentit të IT-së. Gjatë konfigurimit të Hubit seksionet e më poshtme janë shtuar në pjesën e navigimit të faqes: News, Sites, dhe Highlighted Content. Gjatë procesit të navigimit është paraparë të ketë “sharing” të navigimit që ka linqe lidhëse me resuret tjera në intranet. Navigimi zakonisht paraqitet në pjesën e poshtme ose të sipërme (“Footer”, “Header”), ndarja e navigimit mund të bëhet në tre nivele, gjë e cila mundëson organizimin e familjes së hubit në mënyrë që përdoruesit të mundën të gjëjnë kontentin relevant. Krijimi i hubeve të tjera përbrenda insitucionit konsiston në hubet e sicilit fakultet përketes, dhe hubet e administrates, të cilat ndërlidhen me hubin e rektoratit, arkitektura e tyre përsëritet si në figurën 4, por ndryshon konfigurimi i faqeve përbrenda, konfigurimi konsiston si më poshtë:



*Figure 5/Arkitektura e intranetit bazuar ne hubin e fakultetit*

### Faqet e ekipeve ( Team Sites )

